

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. I nga, , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP. II. Nr. 1600/2016, të datës 25.08.2016, më datën 26.08.2016, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit **:Sh.I.** i lindur më..., me vendbanim në....., shqiptar, shtetas i Republikës, i cili

Është fajtor

Sepse më datën 23.08.2016, rreth orës 15.30 min , në ..., në rr. "...", nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që, duke drejtuar automjetin e markës "...", me nr. regj. kundërshtim me dipozitat ligjore neni 55. 1, pika b të Ligjit për Sigurinë në Komunikacion Rrugor, për shkak të mos mbajtjes së distancës së nevojshme në mes automjeteve, ashtu që, me pjesën e përparme të automjetit të tij, e ka goditur në pjesën e pasme të anës së djathtë automjetin e markës "...", me nr. regj...., të cilën e drejtonte J. K , i cili në atë moment ishte duke lëvizur në drejtimin e njejtë qarkullues dhe nga kjo goditje, përvojë dëmeve materiale në të dy automjetet, lëndime të lehta trupore kanë pësuar J. K të cilat, për shkak të këtyre lëndimeve, janë detyruar të kërkojnë ndihmën mjeksore në Qendrën Emergjente në Spitalin Regjional në.....

- me çka ka kryer veprën penale, **rrezikimi i trafikut publik**, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 39 dhe 64 të KPK, si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit Sh. I , i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150€ (njëqindpesëdhjetë)**, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të dëmtuarat J.K, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurës mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **20 €**, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit Sh. I, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtarja, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit Sh. I. dhe të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, deklaratës së të dëmtuarve, raporteve të oficerëve policor, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjykatësja konstatoi se i pandehuri Sh. I. nga P, ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378, paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PPK dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 495 paragrafi 1 lidhur me nenin 365 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
më 26.08.2016

Sekretarja juridike,
Hikmete Veliu-Pajaziti

Gjykatësja,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.